

VENDIM
Nr.56, datë 4.11.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Franc Jakova,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““

me sekretare Arta Palushi, më datë 12.6.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S E : ZENEPE LLOSHI, e përfaqësuar nga Av.Gjon Brunga.

SUBJEKTE TË INTERESUARA :

1. XHOVAN GALLANI, i përfaqësuar nga Av.Kreshnik Spahiu e Ilirjan Rusmali.
2. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, DEGA LUSHNJË, përfaqësohet nga Z.Astrit Kodra, punonjës pranë kësaj dege.
3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË BASHKISË LUSHNJË, nuk u paraqit.

OBJEKTI:

Deklarimi antikushtetues i vendimeve nr.706, datë 11.06.1996 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë; nr.4569, datë 18.09.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.816, datë 22.04.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, duke parashtruar këto shkaqe :

Të tre vendimet gjyqësore të lartpërmendura janë të pabazuara në ligj dhe shkelin rëndë të drejtën time të pronësisë sepse në kundërshtim me nenin 38 të ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, më mohojnë të drejtën e parablerjes.

Kështu, Reparti i Konservimit të Ullirit Lushnjë, ndërtuar nga shteti në truallin për të cilin Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lushnjë më ka njohur si ish-pronare, në vend që të më shitej mua, është lejuar që atë ta privatizojë Xhovani Gallani, që nuk ka asnjë lidhje me të.

Vendimi i Gjykatës së Apelit, është kontradiktor sepse nga njëra anë pranohet se objekti është përjashtuar nga ankandi nga ana tjetër shprehet se unë e kam humbur ankandin.

Përbërja e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit nuk ka qënë e rregullt. Dy anëtarë të tij kanë marrë pjesë në të dy gjykimet që janë zhvilluar në këtë gjykatë për këtë çështje.

Gjykata e Apelit më datat 11 e 18.09.1996 nuk ka zhvilluar fare gjyq, prandaj vendimi i saj është fiktiv.

Gjykata e Kasacionit e ka gjykuar çështjen më 22 prill 1997, pikërisht në kohën e trazirave që ndodhën vitin e kaluar, vetëm e vetëm për të më mohuar të drejtën time.

Vendimet e Gjykatës së Rrethit dhe të Apelit, janë bazuar në ekspertime të falsifikuara dhe të manipuluar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, të subjekteve të interesuara dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkesa e Zenepe Lloshit drejtuar kësaj Gjykate është e pabazuar.

Nuk rezultoi që vendimet gjyqësore objekt i kësaj kërke, të jenë bazuar në të dhënat e ndonjë procesi të parregullt ligjor, i cili të ketë shoqëruar gjykimet e zhvilluara, për padinë që ka ngritur ajo kundër subjekteve të interesuara, Degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Lushnjë

dhe Xhovani Gallanit.

Objekti i kësaj padie, e cila është rrëzuar nga gjykata e rrethit Lushnjë dhe që në të njëjtën mënyrë ka përfunduar edhe në të dyja shkallët e tjera të gjykimit, ka qënë konstatimi i pavlefshmërisë së kontratës së shitjes, e lidhur kjo midis dy subjekteve të interesuara.

Në bazë të këtij veprimi juridik të kryer në kuadrin e privatizimit të pronës shtetërore, subjektit të interesuar Xhovani Gallani, i kalonte në pronësi Reparti i Konservimit të Ullirit, i veçuar nga pjesët e tjera të ish-Ndërmarrjes Ushqimore Lushnjë.

Kërkuesia ka pretenduar se përderisa ky objekt është ndërtuar nga shteti në truallin e saj, ish-pronë private, i takonte asaj e drejta e parablerjes dhe nuk duhej që privatizimi i tij të bëhej nga i lartpërmenduri.

Për këtë shkak, ajo ka kërkuar të deklarohen antikushtetuese vendimet gjyqësore objekt kërkesë. Pra, nga ana e saj vihet theksi tek zgjidhja në themel e çështjes. Sipas kërkueses, gjykimi i saj është shoqëruar me interpretim e zbatim të gabuar të ligjit material, në radhë të parë të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, pa përjashtuar këtu edhe aktet e tjera nënligjore, siç është udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.13, datë 18.10.1993.

Ndaj këtij pretendimi, Gjykata e çmon të nevojshme të sqarojë se nuk është detyrë e saj të kontrollojë vendimet gjyqësore nga pikëpamja e bazueshmërisë së tyre në prova, ose të verifikojë nëse ato janë rezultat i interpretimit dhe zbatimit të drejtë ose jo të ligjeve materiale. Përkundrazi, këto janë çështje zgjidhja e të cilave është në kompetencën ekskluzive të gjykatave të zakonshme.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për pretendimin tjetër të kërkueses lidhur me konkluzionet e ekspertëve, të cilët kanë bërë matjet e truallit të privatizuar nga Xhovani Gallani.

Detyrë e saj primare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, është që ajo të kalojë nëpër sitën e kontrollit të saj konstitucional, qëndrimin që mbajnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme organet e tjera, por vetëm përsa i përket respektimit të atyre rregullave dhe parimeve procedurale, të cilat garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë e të paanshëm.

Megjithatë, në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, krahas pretendimeve të sipërme, janë ngritur edhe pretendime të tjera, të cilat meritonin të verifikoheshin në rrugën e kontrollit kushtetues.

Kështu, kërkuesia ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë, kur i ka ardhur çështja për herë të dytë, pas rigjykimit të saj në gjykatën e rrethit Lushnjë, nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Sipas saj, shkëlja e kësaj të drejte kushtetuese është manifestuar në formën e përbërjes së parregullt të trupit gjykues, sepse nga tre gjyqtarët që kanë dhënë vendimin, dy prej tyre kanë marrë pjesë edhe në gjykimin e parë, kur është vendosur dërgimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit.

Përsa i përket këtij pretendimi, Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë përmbajtjen e nenit 11 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992 “Për organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese” si dhe atë të dispozitave të Kodit të mëparshëm të procedurës Civile, i cili ka qënë i zbatueshëm në kohën që është gjykuar çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Sipas këtyre dispozitave, pjesëmarrja për të dytën herë e gjyqtarëve të kësaj gjykate në gjykimin e çështjes në të njëjtën shkallë, nuk përbën fare shkelje procedurale, në kuptimin e përbërjes së parregullt të trupit gjykues. Vetë fakti që në gjykimin e parë ata nuk janë shprehur për çështjes, por kanë pranuar kërkesën ankimore të kërkueses për dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit, me orientim që të zgjerojë hetimin gjyqësor, tregon se ata nuk janë kompromentuar për paanësinë e tyre, veçanërisht në dëm të kërkueses.

Nga ana tjetër, për çdo njërin nga këta gjyqtarë nuk ekzistojnë asnjë prej kushteve të tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, për të cilat gjyqtari është i detyruar vetë të mosmarrë pjesë në zgjidhjen e çështjeve ose të kërkohet nga palët përjashtimi i tij nga gjykimi. Madje, nuk rezulton që edhe vetë kërkuesia të ketë bërë paraprakisht ose gjatë gjykimit ndonjë kërkesë në këtë drejtim, ndonëse ajo është njohur me përbërjen e trupit gjykues.

Së dyti, i pabazuar është edhe pretendimi tjetër i kërkuesës, së Gjykata e Apelit ka shpallur vendimin nr.4569, datë 18.09.1996, pa bërë fare gjykim për çështjen. Përkundrazi, në dosje ndodhen dy procesverbale që vërtetojnë hapjen e seancës gjyqësore nga ana e kësaj gjykate; i pari mban datën 11 shtator dhe tjetri datën 18 shtator 1996.

Në këto akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, është pasqyruar se më datën 11 shtator 1996, ka filluar shqyrtimi i çështjes me relativimin e saj nga gjyqtari, i cili ka lexuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe kërkesën ankimore, së është dëgjuar pala ankuese, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pala tjetër, që ka kërkuar lenien në fuqi të vendimit dhe se në fund, kur është kthyer trupi gjykues

pas tërheqjes së tij në dhomën e bisedimit, iu ka komunikuar atyre se shpallja e vendimit shtyhëj për në datën 18.09.1998. Në këtë datë është mbajtur edhe procesverbali i dytë, ku është shënuar se ky vendim u shpall në prani të palëve.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të dalë me konkluzione, duke pranuar fakte në kundërshtim ose tej përmbajtjes së këtyre akteve.

Të njëjtin qëndrim mban ajo edhe përsa i përket pretendimeve që ka ngritur kërkuesia në lidhje me gjykimin e kësaj çështje në kolegjin civil të Gjykatës së Kasacionit. Fakti se ky kolegji e ka zhvilluar gjyqin në kohën e trazirave ose ngjarjeve që ndodhen vitin e kaluar, nuk do të thotë se kërkueses i është shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese, e cila të ketë ndikuar negativisht në zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor.

Për më tepër, shqyrtimi i çështjes në këtë shkallë gjykimi ka filluar mbi rekursin e ushtruar prej saj. Kolegji civil është njohur kështu me të gjitha shkaqet, për të cilat ajo ka kërkuar prishjen e vendimeve të dhëna në dy shkallët e tjera të gjykimin. Në qoftë se për shkak të vështirësive të krijuara ajo është penguar të paraqitë ditën e gjykimin në Gjykatën e Kasacionit, i ka pasur të gjitha mundësitë që çështjen ta ndiqte nëpërmjet avokatit të saj ose të caktonte avokat tjetër, aq më tepër që edhe në situata normale, në këtë Gjykatë nuk lejohet pjesëmarrja personalisht e palëve.

E pabazuar është kërkesa e saj edhe në pjesën që ajo atakon vendimin e Gjykatës së Kasacionit, nga pikëpamja formale. Mënyra e formulimit të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, se rekursi nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i Kodit Civil, në rastin konkret është e rregullt. Fakti se në këtë pjesë të vendimit nuk u jepet përgjigje e detajuar të gjitha pretendimeve të kërkueses, nuk do të thotë se ky vendim është i paarsyetuar, përderisa shkaqet e parashtruara në rekurs, që serviren si shkaqe ligjore, për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj as në materialet e çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së Zenepe Lloshit si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës.

Kërkueses Zenepe Lloshi, e njohur si ish-pronare e një trualli me sipërfaqe rreth 5000 m2, i është mohuar padrejtësisht në mënyrë arbitrare, si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, e drejta e parablerjes.

Shkaqet që ka parashtruar kërkuesja në Gjykatën Kushtetuese janë të drejta dhe ligjore, të cilat shumica e kësaj gjykate në vendimin e saj, nuk i ka pranuar, duke i rrëzuar kërkesën. Vendimi i shumicës është një devijim nga praktika dhe qëndrimi që ka mbajtur për këto raste Gjykata Kushtetuese.

I gjithë procesi ligjor që ka filluar me vendimin e Komisionit të Kthimit të Pronave ish-Pronarëve të qytetit Lushnjë, me vendimin e Bordit të Privatizimit, dhe me tre vendimet e gjykatave, është cënuar, dhe duhej të konsiderohej i parregullt nga shumica dhe kërkesa duhej pranuar për këto arsye:

Së pari: Kërkueses i është mohuar e drejta e parablerjes.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.7, datë 10.04.1998 në një çështje analoge me të, ka arsyetuar se: “... e drejta e parablerjes është një e drejtë primare e ish-pronarëve të truallit mbi të cilin ndodhet objekti që i nënshtrohet privatizimit dhe si mënyrë fitimi e pronës së rregulluar me ligj,

përbën një të drejtë kushtetuese të pacënueshme, e cila nuk mund të mohohet jashtë vullnetit të ish-pronarit, pavarësisht nga pjesa që i takon në privatizim...”

Ky është një konkluzion i drejtë dhe ligjor, i mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, që shpreh një qëndrim dhe njëkohësisht një praktikë ligjore, e cila pavarësisht se i përket një çështjeje tjetër, nuk mund të anashkalohet dhe injorohet nga po kjo Gjykatë në çështje të tjera.

Së dyti: I njëjti trup gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë e ka shqyrtuar këtë çështje dy herë, për të cilën ka dhënë dy vendime që në arsyetimin e tyre e kundërshtojnë hapur njëri-tjetrin, duke mos kuptuar se cili vendim është i drejtë dhe duhet respektuar. Pavarësisht se njëri vendim e ka kthyer çështjen për rigjykim, duke lënë dhe detyra të cilat nuk janë zbatuar dhe tjetri ka vendosur lënien në fuqi të tij, Ky trup gjykues i Gjykatës së Apelit ka shkelur rëndë nenin 11 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit : “... gjyqtarët janë të detyruar të mos marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve, kur ka shkaqe ligjore që kompromentojnë paanësinë e tyre, si dhe të mënjanojnë çdo sjellje, që vë në dyshim real drejtësinë ose ul dinjitetin e saj...”

Kur kjo çështje u paraqit përsëri për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ekzistonte detyrimi kushtetues për dy anëtarë të këtij trupi gjykues që të hiqnin dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i saj, sepse ata ishin shprehur më parë për të.

Kjo dispozitë kushtetuese që është e detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo gjyqtar, nuk është vlerësuar nga shumica si shkelje kushtetuese që të çënojë procesin gjyqësor.

Së treti: Në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Kasacionit, kërkesia ka parashtruar katër shkaqe ligjore, të cilat objektivisht ekzistojnë në dosjen gjyqësore.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit shprehet në vendimin e tij se shkaqet e parashtruara nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Referuar nenit 9 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, ka detyrimin kushtetues që vendimin gjyqësor duhet ta arsyetojë dhe të jap përgjigje ligjore shkaqeve të pretenduara në rekurs nga kërkesja. Mosarsyetimi i vendimit dhe mos argumentimi ligjor i arsyeve të refuzimit të këtyre shkaqeve, të cilat në fakt kanë qënë të mjaftueshme për gjykatën, jo vetëm që është shkelje e hapur e dispozitave kushtetuese, por njëkohësisht çënon drejtëpërsëdrejti interesat e shtetasve për zhvillimin normal të një procesi të rregullt ligjor, kërkesë kjo e nenit 38 të ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Argumentat ligjore të shprehura në këtë mendim pakice, janë përgjigje e shkaqeve që kërkesja ka ngritur pranë Gjykatës Kushtetuese, por që për një votë u vlerësuan nga shumica, si shkaqe që nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e akteve të mësipërme, duke e konsideruar të rregullt të gjithë procesin ligjor që është ndjekur për këtë çështje.

ANËTA R
K. Puto

ANËTA R
H. Dakli

ANËTA R
S. Sadushi

MENDIMI I PAKICËS

Bashkohem me mendimin e anëtarëve të tjerë të kësaj Gjykate, të mbetur në pakicë. Jam edhe unë për pranimin e kërkesës, që të deklarohen antikushtetuese të tre vendimet e kundërshtuara nga kërkesia Zenepe Lloshi.

Në përgjithësi, jam dakord edhe me argumentat që parashtrojnë ata dhe që shërbejnë si shkak për shfuqizimin e këtyre vendimeve.

Me mendimin e tyre nuk pajtohem vetëm në një pikë. Unë nuk i quaj të bazuara pretendimet që ka ngritur kërkesia në lidhje me parregullsitë që sipas saj kanë shoqëruar gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kështu, fakti se dy gjyqtarë të kësaj gjykate kanë marrë pjesë dy herë në gjykimin e kësaj çështjeje në të njëjtën shkallë, për mua nuk përbën asnjë shkelje të rregullave procedurale.

Nga ana tjetër, pretendimi i kërkeses se kjo Gjykatë e ka shpallur vendimin e saj të datës 18.09.1996 pa zhvilluar fare gjyq, nuk gjen mbështetje në prova. Përkundrazi në dosjen gjyqësore

ndodhen dy procesverbale të mbajtur, njëri në datën 11 dhe tjetri në datën 18 shtator 1996, që vërtetojnë se shqyrtimi i kësaj çështje në këtë gjykatë është zhvilluar normalisht.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i kundërvihet këtyre akteve me fuqi të plotë provuese. Ajo nuk mund të pranojë fakte në kundërshtim ose tej përmbajtjes së tyre, përderisa nuk është vërtetuar në rrugën e gjykimit të zakonshtëm se ato janë të falsifikuara.

A NËTA R
Zija Vuci